

VENDIM
Nr. 154, datë 30.3.1997

PËR SHTYRJEN E AFATIT TË VLEFSHMËRISË SË PASAPORTAVE TË ZAKONSHME
TIP I VJETËR SI DOKUMENT IDENTITETI DHE PAJISJEN ME PASAPORTA TË REJA

Me propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe të Ministrisë së Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Afati i vlefshmërisë së pasaportave të zakonshme tip i vjetër, që do të shërbejnë vetëm si dokument identiteti dhe jo si dokument udhëtimi jashtë shtetit, për shtetasit shqiptarë që ndodhen jashtë shteti, shtyhet gjer më 31 dhjetor 1997.

2. Për të gjitha rastet e kërkesave të paraqitura rregullisht në përfaqësitë diplomatike e konsullore të Republikës së Shqipërisë nga shtetasit shqiptarë me banim jashtë shtetit deri më 31 maj 1997 procesi i pajisjes së tyre me pasaporta të zakonshme të reja duhet të përfundojë deri në datën 31 dhjetor 1997.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Punëve të Jashtme. Ministria e Brendshme duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të përshpejtuar procesin e plotësimit të pasaportave të reja, mbi bazën e kërkesave të paraqitura.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino